



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborna komisija za žalbe i molbe

**A nr. 200/2010**

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Ymer Hoxha dhe Sali Toplica, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Zoran Nikoliq kryetar i OJQ-së "GRUDA" nga fshati Pasjan - Gjilan, që ka të bëjë me parregullsitë gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16 Korrik 2010 mori këtë:

### V E N D I M

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

### A R S Y E T I M I

Z. Zoran Nikoliq kryetar i OJQ-së "GRUDA" nga fshati Pasjan-Gjilan, ka parashtruar ankesë më datë 22.06.2010, me të cilën pretendon se Z. Bogoljub Staletoviq, Zëvendës kryeshef i KQZ-së më datë 20.06.2010, në VV nr. 3602/01R pas orës 13:15 ka formuar një turmë njerëzish dhe kanë ardhur me votuesit të cilët kanë votuar në orët e mëngjesit. Kjo gjë ndodhi pas vizitës së zëvendës kryeshefit të KQZ-së të Sekretariatit e KQZ-së së bashku me vozitësin e tij, Aca.

### F A K T E T

Më 13 korrik 2010, KZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Z. Zoran Nikoliq kryetar i OJQ-së "GRUDA" nga fshati Pasjan-Gjilan.

Parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi apo deklaratë të dëshmitarëve si provë lidhur me turmën e votuesve, vetëm se ka cekur emrat e Milan Cvetkoviq, Danilo Cvetkoviq, Marko Cvetkoviq dhe Goran Trajkoviq si dëshmitar. Po ashtu, parashtruesi i ankesës nuk ka treguar qartë për ngjarjen e supozuar, në lidhje me turmën e njerëzve të mbledhur.

### A N A L I Z Ë

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

*3.6 (b) Një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar*

*3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, ne rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit*

KZAP-i vlerëson se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e detyrueshme të parashikuara në dispozitat e nenit 3.6 pika (b) dhe pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

A nr. 200/2010 më datën 16 Korrik 2010

